

INFRASTRUKTURA DHE KALIMI EFIKAS NËPËR PIKAT KUFITARE: Maqedoni-Shqipëri, Kosovë, Sërbi

Zija ZIMERI¹, Nexhmedin BLLACA² & Blerta ZIMERI³

ABSTRAKT

Infrastruktura dhe kalimi efikas nëpër pikat kufitare Maqedoni-Shqipëri, Kosovë-Sërbi. Pikat kufitare Tabanovcë në mes shteteve në nivel ndërkombëtarë, rajonal, korridoret M-75 koridori-10 dhe E-65 koridori 8. Infrastruktura e objekteve të ndërtuara për kryerjen e shërbimeve doganore, administrative, primare, sekondare. Infrastruktura rrugore krosite, kapacitetet, sinjaliteti. Pika kufitare Bllacë E-65 e cila lidhë bregdetin Adriatikut, Malin e zi, Kosovën, në Shkup lidhet me korridorin 10 dhe 8. Pika kufitare Jazhincë- me motivet bukura natyrore Sharri, flora, pauna, vegjetacione, biodeversiteti lidhë Tetovën-Pollogin me Ferizajin dhe Prishtinen. Kufiri Maqedono Shqiptar – Qafthana, koridori 8 Durrës (Shqipëri), Qafthan (Strugë)-Shkup, Ohër, Resnjë, Manastir dhe pastaj lidhet me magjistralen E-75 me korridorin 10. Via Egnatia, Durrës , Ohër, Manastir dhe Selanik, Infrastruktura, karakteri ndër shtetërorë. Pika kufitare Shën Naum – Qyteti Ohërit nga Maqedonia dhe Pogradeci nga Shqipëria, Ohër-Shën Naum-Pogradec. Pika kufitare Stenjë ndodhet larg Resnjes 10 km ndodhet tek lokaliteti turistik Otoshevë dhe pushimores Dogana-Stenjë ka karakter lokal ndër kufitar me kushtin malor klimatik.

ABSTRACT

Infrastructure and efficient transition through the border point in Macedonia-Albania ,Kosovo-Serbia. The border points Tabanovce between states in international level, corridors M-75 Corridor-10 and E-65 Corridor 8 regional. The infrastructure of the constructed objects, perform customs administration, primary, secondary services. The road infrastructure, capacity, signality. The border point Blace E-65, which connects the Adriatic coast, Montenegro, Kosovo, in Skopje connects with corridor 8 and 10. The border point Jazine – with beautiful natural motifs, Sharr mountain flora, fauna, vegetation, the biodiversity connect the Tetova city with Pristina and Ferizaj. The Macedonian Albanian border - Kafasan, Corridor 8, Drac (Albania), (Struga)-Skopje, Ohrid, Resen, Bitola and then

¹ **Doc. Dr. Zija ZIMERI**, e-mail: zija.zimeri@unite.edu.mk, zija.zimeri@hotmail.com
Universiteti Shtetëror i Tetovës; Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore.
Cel: +389 70 398600, www.unite.edu.mk

² **Prof. Nexhmedin BLLACA**, e-mail: nexhmedinb@live.com, Gjilan.

³ **Ing. Dip. Blerta ZIMERI**, e-mail: zija.zimeri@hotmail.com, Shkup.

connects to the highway E-75 with corridor 10. Via Egnatia—Drac, Ohrid, Bitola and Infrastructure, the character of the state. The border point St. Naum – Ohrid City in Macedonia and Pogradec in Albania, Ohrid- St. Naum- Pogradec. The border point Stenje is located 10 km away from Resen and it is located in the tourist locality Otosevo and the resort in Stenje have local character with cross-border mountain climate condition.

1. HYRJJE

Në kufirin maqedono-kosovar dhe në kufirin Sërb ekzistojnë këto pika kufitare: Jazhincë në (Tetovë), Bllacë (Shkup), dhe Tabanovcë (Kumanovë), kurse pika më të vogla kufitare janë Sopot dhe Pelincë në Kumanovë. Përveç këtyre, nga ana e R.M ekziston interes që të hapet edhe pika kufitare në fshatin Llojan e cila nga njëra anë do të mundëson komunikimin më të shkurtër mes fshatërave që gjenden në regjionin e Likovës dhe nga ana tjetër të vendbanimeve të luginës së Preshevës (në Republikën e Serbisë). Edhe pse rruga prej fshatit Miratoc-Llojan është asfaltuar vullneti mes dy shteteve mungon, po me rëndësi është të çeket edhe kufiri me Republikën e Kosovës që lidhë fshatrat e komunës së Likovës – fshati Belanovc me fshatin Stancic- Kosovë është duke u punuar që kërkon një angazhim të ndërsjellë që edhe fshatra e boshdisura si edhe fshati Strazh që është vetëm tri kilometra në anën e djathtë që kufizohet me Kosovën me fshatin Dunav që është duke u punuar me vet inicjativën e fshatarëve që të ia kërkojnë sado pakë gjallërinë se është mundësija për zhvillimin e një turizmi familjar-nderkufitar mes këtyre tre shteteve Maqedoni-Kosovë dhe Kosovë –Sërbi për një lloj të zhvillimit të turizmit alternativ-rrural që sado pak të zbut papunsinë kufitare.

2. OBJEKTET E NDËRTUARA NË PIKËN TABANOVCË

Objektet e ndërtuara në pikën Tabanovcë i kanë këto përmbajtje: kanal të tipit të mbyllur për kontrollim të automjeteve, vendparkim për 40-50 vetura për nevojat e MPB-së dhe Doganës, objekt restoranti, garazhë për nevojat e AMSM-së. Gjithashtu, në këtë pikë kufitare hasen objekte për nevojat e përgjithshme të doganës, PTT-së, AMSM-së, dhe shërbimeve për shpediton, hapësira për agjencionet turistik edhe shitore, 15 zyra për shpediton të vendosura në hapësira të posaçme, freeshope, të cilat që nga viti 1994 nuk janë në përdorim. Përveç kësaj në vet pikën kufitare ka hapësira për njësinë fitopatologjike, hapësira për njësitë sanitare dhe hapësira për njësitë veterinarë etj.

Për nevojat e doganës Tabanovcë në Kumanovë, firma Fershped ka të ndërtuar terminal për mjetet e rënda transportuese me këto përmbajtje: vend parkim, porta hyrëse-dalëse, vend për kontroll të detajuar, vend për ngarkim dhe shkarkim, depo për vendosjen e mallrave nën mbikqyrje sanitare dhe të doganës, kontenjer për vendosjen e mallrave që nuk janë në përdorim.

Gjatë vitit 2004, në këtë pikë kufitare janë ndërtuar përmbajtje të reja, para se gjithash për realizimin e pandërprerë të trafikut është bërë zgjerimi i dy krosive, është bërë rikonstruktimi i krosive të gjertanishme, kështu që sot funksionojnë 12 krosi, 7 hyrëse nga Serbia për Maqedoni dhe 5 dalëse nga Maqedonia për Serbi.

Për funksionim të pandërprerë, sa më efikas dhe sa më të sigurtë të njëjësive doganore në Tabanovcë, si pikë kufitare më e rëndësishme nga Serbia dhe për qarkullim sa më të sigurtë të trafikut, në vet pikën kufitare janë vendosur këto përmbajtje: mezo-barriera në hyrje të Maqedonisë nga Serbia, peshore për mjetet e rënda transportuese në krahun që shpie kah terminali, vend me kanal të hapur për kontrollimin e autobusëve, objekt me kanal të hapur për kontrollim të veturave, objekte për shërbime dhe sanitare publik, bankë, këmbimore, shitore dhe shpedicione, objekte të dedikuara për nevojat e njëjësive doganore, fitosanitare dhe atyre të veterinarisë.

Nga Kumanova gjer në pikën kufitare Tabanovcë shpie rruga magjistrale e cila ka nevojë që të zgjerohet dhe të rikonstruktohet sipas kriterëve të vendosur nga bashkësia europiane, me të vetmin qëllim që të bëjë pjesë në traktet trafikore ndërkombëtare. Sipas projektit AGRID që është miratuar në vitin 2004, rruga në relacionin Kumanovë-Tabanovcë parashihet që të zgjerohet edhe me dy krosi shtesë, për shkak të intenzitetit të madh të kalimit të njerëzve, të veturave dhe të transpoteve të rënda motorike, si dhe të mjeteve të ndryshme. Gjithashtu, parashihet që në Tabanovcë dhe Kumanovë të ndërtohen edhe objekte të tjera në interes të doganës dhe të shtetit në përgjithësi, pasi që Maqedonia importon nga Serbia gati 40 % të mallrave të ndryshëm industrial, energjetik etj, si dhe artikuj të ndryshëm ushqimor dhe bujqësor. Tashë nga projekti AGRID është realizuar ndertimi I terminalit për doganim dhe zhdoganim të mallrave në mes pikës kufitare Tabanoc dhe qytetit të Kumanovës dhe objekti dhe pistat për valorizim të udhëtareve hyrje-dalje është realizuar.

Pika kufitare Tabanovcë ka dy dogana, respektivisht në rrugën M-1(E-75) dhe stacionin hekurudhor Tabanovcë, i cili ndodhet në anën e djathtë në afërsi prej 500 metrave. Vija hekurudhore Tabanovcë ka karakter ndërkombëtar dhe paralelisht me rrugën magjistrale M-1, kanë drejtim meridianor të shtrirjes. Kjo vijë hekurudhore është e ndërtuar që në kohën e Perandorisë Otomane në ndërtimin e së cilës ka marrë pjesë edhe

kapitali francez, ashtu që për këtë anë njihet edhe me emrin “ hekurudha franceze”.

Në stacionin hekurudhor Tabanovcë ekzistojnë 8 kalime për ndërrimin e trenave, hekurudha është e elektrifikuar dhe ka hapësira për realizimin e të gjitha detyrave të vendosura nga ana e doganës, si dhe me detyrat që kanë të bëjnë me realizimin e trafikut hekurudhor.

Në këtë pikë kufitare (në stacionin hekurudhor Tabanovcë) ka polici kontrolluese dhe njësi doganore të vendosura në hapësira të posaçme, ka PTT trafik, këmbimore, shitore etj. Në të ardhmen është e patjetërsueshme që të ndërmerren aktivitete në lidhje me furnizimin e mëtutjeshëm të zyrve doganore me teknologjinë e nevojshme kompjuterike dhe lidhjen me pikën kufitare Tabanovcë. Gjithashtu duhet të ceket se këto dy kalime doganore janë të lidhura në mënyre elektronike me drejtorinë doganore të Kumanovës. Gjithashtu, është e patjetërsueshme që të stimulohet ndërtimi i objekteve të nevojshme infrastrukturore për nevojat e doganës, hapësira që kanë të bëjnë me përmirësimin e komoditetit të doganierëve, hapësirë më adekuate për policinë, ndërtimin e objekteve për trafik të PTT-së, këmbimore, banka, dhe restorante etj.

Me qëllim të komunikimit mes tyre, është e rëndësishme që në mes këtyre dy kalimeve të ndërtohet rrugë e asfaltuar, sepse rruga e gjertanishme është rrugë fshatare tokësore.

3. PIKA KUFITARE BLLACË

Pika kufitare Bllacë është e krijuar në vitet e nëntëdhjeta me pavarësimin e Maqedonisë (1991). Kjo pikë kufitare ndodhet në të ashtuquajturën magjistrale e Adriatikut E-65, e cila e lidh bregdetin e Adriatikut, Malin e Zi, Kosovën, kurse në Maqedoni respektivisht në Shkup lidhet me korridorin 10 dhe korridorin 8. Këto korridore për Republikën e Maqedonisë paraqesin objekte të rëndësishme strategjike për zhvillim të përgjithshëm ekonomik dhe lidhje më të lehtë me shumë vende të Europës dhe të Mesdheut.

Nëpër luginën e lumit Lepenc kalon edhe vija hekurudhore, e cila e lidh Prishtinën me Shkupin dhe më pas kjo vijë lidhet me vijat tjera hekurudhore në Maqedoni dhe në Serbi.

Qasja në pikën kufitare bëhet përmes dy krosive trafikore (hyrëse dhe dalje), dhe me këtë kjo pikë kufitare disponon me 4 krosi. Megjithatë kontrolli doganor në hyrje dhe dalje kryhet në dy krosi, kurse mes tyre ka edhe krosi për ndalje, ndërsa nga ana e kundërt numri i krosive është po i njëjtë, dhe i vërtetuar me protokoll për bashkëpunim ndërkuftar.

Për mjetet e rënda transportuese ekziston krosi baj-pas, për kontrollime policore dhe doganore që janë të vendosura në objekte të

posaçme, ku ekziston veçmas e tërë përmbajtja, respektivisht objekte që janë funksionale për punën e doganës.

Në këtë kompleks ndodhen këto objekte: hapësirë për kontrolle doganore dhe policore të vendosura në objektin kryesor, hapësira për kontrolle speciale për persona. Nga objektet e tjera më të rëndësishme të grupuara rreth magjistrale janë: peshorja doganore, posta, AMSM, banka, këmbimore të vendosura në dalje në të ashtuquajturën zonë neutrale, më pas nga objektet e mbetura janë: terminali për shpeditcion dhe restorant ku ka vend parkim për veturat e lehta dhe për mjetet e rënda transportuese.

Pjesa urbane e pikës kufitare përfshinë një sipërfaqe prej 5.5 hektarë dhe paraqet një pikë të re kufitare dhe moderne, e cila është e zgjeruar dhe e modernizuar sipas normave dhe kriterëve europiane, e ndihmuar nga ana e forcave për ruajtjen e paqes të Kombeve të Bashkuara.

Nëpër lugina ndodhet edhe vija hekurudhore e cila e lidh Shkupin me Prishtinën. Pika kufitare hekurudhore Vollkovë është e vendosur në stacionin hekurudhorë në fshatin Vollkovë. Në këtë pikë kufitare janë të vendosura objekte për policinë dhe doganën, PTT, lidhjet elektronike, këmbimoret etj. Trenat që bartin mallra kontrollohen në Shkup, ku ekzistojnë të gjitha mjetet për rrjedhjen normale të veprimtarisë doganore, doganimin e mallrave etj, kurse në vet pikën kufitare kontrollohen udhëtarët për doganim. Në këtë pikë kufitare ka rend taksativ të udhëtarëve dhe treni për udhëtarë këtë pikë kufitare e kalon katër herë në ditë.

Pika kufitare Jazhincë ka natyrë më të bukur. Nga njëra anë janë malet e Sharrit (Lubeten) të mbuluara me florë të dendur dhe dhe vegjetacion të ulët dhe të llojlojshëm, me burime të shumta dhe proska të shkurtëra. Për këtë regjion, gjithashtu janë karakteristike arrat, lajthitë etj, kurse hapësira nga fusha e Pollogut kësaj pjese i jep bukuri të posaçme me llojlojshmërinë e peizazhit agrar.

4. PIKA KUFITARE JAZHINCË

Pika kufitare Jazhincë lidhet me qytetin e Tetovës dhe Pollogun me anë të rrugës së re magjistrale e cila kalon prej Tetovës nëpër fshatrat e Pollogut (Xhepcishtë, Leshok, Sllatinë, Tearcë dhe Vratnicë), dhe shpie drejt Ferizajit dhe Prishtinës. Kjo rrugë paraqet rrugë të re magjistrale që është ndërtuar në kohën e nëntëdhjetave. Kjo rrugë magjistrale në Tetovë lidhet me rrugën magjistrale M4 dhe paraqet boshtin e dytë zhvillimor më të rëndësishëm (korridori 8).

Duke pasur parasysh se ky vendkalim paraqet një pikë të re kufitare, dhe duke e pasur parasysh rritjen e frekuencës të kësaj pike kufitare, sipas Drejtorisë Doganore dhe Ministrisë për Financa, ishte paraparë ndërtimi i

objekteve më të nevojshme, që qakullimi të rrjedh pa ndërprerë, sa më efikas dhe për një bashkëpunim ekonomik. Kjo pikë kufitare është projektuar dhe realizuar sipas planit nga ana e Qeverisë së Maqedonisë në vitin 1992 dhe punët u kryen në vitin 1993, me qëllim të funksionimit të pandërprerë të kësaj pike kufitare, dhe kyçjen e saj të plotë në qarkullimin ndërkombëtarë të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe rrjedhjen sa më të sigurtë të trafikut në vet pikën kufitare.

Duke e pasur parasysh sasinë e qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, në këtë pikë kufitare është bërë organizim optimal i mikrohapësirës përreth pikës kufitare me koncentrim maksimal të përmbajtjeve dhe funksioneve që kryhen në këtë pjesë.

Pika kufitare Jazhincë ka funksionuar me një rrugë hyrëse dhe një dalëse dhe ka pasur këto përmbajtje: ndërtesën themelore, kabinete kontrolluese, garazhe për kontrollim të veturave, vendparkimin për rreth 40 mjete transportuese, depo për mallra, objekte për doganim etj.

Përveç pikave kufitare të përmendura në kufirin verior ndodhen edhe pikat kufitare Sopot dhe Pelincë të cilat kanë funksion ndërshtetëror lokal.

Në kufirin maqedono-shqiptar pikë kufitare më frekvente është Qafëthana. Në këtë pikë kufitare kalon korridori 8, respektivisht rruga magjistrale e cila i lidh qendrat e rëndësishme urbane lindje -perëndim, respektivisht Durrës (Shqipëri), nëpërmjet Qafëthanës (Strugë)-Shkup, Kumanovë, Kriva Pallankë, Qustendil, Sofje, si dhe rruga e asfaltuar e cila shpie nga Struga-Ohri-Resnja-Manastiri dhe më tej lidhet me magjistralen E-75, respektivisht me korridorin 10. Në të kaluarën, kjo magjistrale i ka lidhur viset perëndimore dhe lindore të Maqedonisë e quajtur Via Egnatia. Sot këtë funksion e luan rruga Durrës, Ohër, Manastir dhe Selanik.

Për funksionimin sa më efikas të kësaj pike kufitare, në vitet e nëntëdhjeta janë bërë disa objekte për nevojat e doganës. Këto objekte të ndërtuara kanë të bëjnë me ndërtimin e përmbajtjeve të reja siç janë: kanal i tipit të mbyllur për kontrollim të veturave, vendparkim për 40-50 vetura për nevojat e MPB- së dhe doganës, pastaj garazhe për nevojat e AMSM-së. Gjithashtu në pikën kufitare Qafëthanë për punët themelore të Doganës, të PTT, AMSM, nga Nacionalshpedi dhe nga Komuna e Strugës është ndërtuar një objekt i përbashkët, për nevojat e Interimpeksit u ndërtuan hapësira për agjencion turistik (dhe freeshop), të cilat që nga viti 1994 nuk janë në përdorim.

Në këtë pikë kufitare Fershped ka ndërtuar terminal për mjetet e rënda transportuese edhe atë me këtë përmbajtje: vend parkim, rampë hyrëse-dalëse, vend për kontroll detal, vend për ngarkim-shkarkim të mallrave, depo për vendosjen e mallrave nën mbikëqyrje doganore dhe sanitare, kontejner për vendosjen e mallrave jashtë përdorimit i përgatitur me

mjete adekuate dhe i rrethuar me rrethore. Pastaj duhet të ceket se në këtë pikë kufitare Nacionalshped ka hapësira me mjete adekuate për lidhje me punktet, hapësirë për PTT me kabina publike për të komunikuar, kurse në proces të ndërtimit janë hapësirat për fitopatologji, hapësirat sanitare dhe për veterinarinë etj.

Gjithashtu, është parashikuar ndërtimi i servisit për riparimin e veturave. Për nevojat e mirëmbajtjes së rrugëve (Makedonija Patt, RSIZ për rrugë) është parashikuar ndërtimi i një punkti dimëror me këto përmbajtje: garazh për një automjet, hapësira për rërë dhe kripë, dhoma për qëndrim të tre personave të punësuar. Këto hapësira janë të planifikuara të ndërtohen rreth 500 metra para pikës kufitare.

Për rrjedhë të pandërprerë të trafikut, duhet të bëhet ri konstruktimi i pikës kufitare Qafëthanë e cila ka rëndësi ndërkombëtare dhe është e para edhe sipas qarkullimit të njerëzve ashtu edhe sipas kalimit të mallrave nga dy vendet fqinje.

5. PIKA KUFITARE QAFËTHANË

Pika kufitare Qafëthanë është pika e fundit e korridorit 8, në hapësirën e Maqedonisë, e cila i lidh vendet lindje-perëndim. Ky drejtim rrugor fiton një rëndësi gjithnjë e më shumë për lidhjen e drejtpërdrejtë mes Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe të vendeve nga Europa Perëndimore, kurse në lindje Maqedonia lidhet me Bullgarinë si dhe me vendet e tjera të Europës Lindore, të Lindjes së Afërt dhe të Mesme.

Për kryerjen e pandërprerë dhe të sigurtë të detyrave të drejtorisë doganore dhe kontrollimi i kalimit të kufirit shtetëror dhe si rrjedhjen e sigurtë të trafikut në vet pikën kufitare janë të vendosura këto përmbajtje: ndërtimi i dezo-barrierave në hyrje të Maqedonisë nga Shqipëria, dislocimi i peshores për mjetet e rënda transporuese e vendosur në drejtimin që shpie nga terminali, objekt për kontrollim doganor të automjeteve me kanal të hapur, ndërtimi i freeshopeve në anën e djathtë të daljes nga Maqedonia me parking të rregulluar dhe furnizim me mallra, banka, agjencioni turistik, shitore shpedicion.

Gjithashtu në suaza të pikës kufitare Qafëthanë parashikohet ndërtimi edhe i një krahu për nevojat e doganës, veterinarisë dhe njësisë fitopatologjike, pastaj sipërfaqe për ndërtimin e lokaleve me përmbajtje të ndryshme. Pika kufitare Qafëthanë tërësisht është e inkuadruar në qarkullimin ndërkombëtarë të udhëtarëve si dhe mallrave, si dhe për funksionimin e sigurtë të trafikut në vet pikën kufitare.

Me këtë është bërë organizimi më optimal i hapësirës rreth pikës kufitare me koncentrim maksimal të përmbajtjeve dhe funksioneve që kryhen në hapësirën e përmendur.

Gjer më tani, i pika kufitare Qafëthanë ka funksionuar me tre krosi hyrëse dhe dalëse, por është paraqitur nevoja që të vendosen edhe më shumë krosi të tjera për shkak të frekuencës më të madhe të njerëzve dhe të mallrave ndërmjet dy vendeve. Kjo pikë kufitare i ka këto përmbajtje: ndërtesën kryesore, restorant dhe kafene të cilat janë në funksion, ndërsa objektet e tjera nuk ekzistojnë pasi që ndodhet në afërsisë të qytetit të Strugës, i cili disponon me infrastrukturë të nevojshme për nevojat e udhëtarëve e posaçërisht për turistët e huaj (restorante, hotele etj).

Rregullimi trafikor në Qafëthanë është bërë në bazë të vendimit të mëparshëm trafikoro-urbanistik. Në bazë të nevojave të gjertanishme dhe marrëveshjes ndërkombëtare është vërtetuar edhe gabariti i rrugëve mes dy vendeve, me qëllim që të realizohet ndërtimi i dy rrugëve 13,00 m të gjëra dhe me një largësi të ndarë njëra prej tjetrës prej rreth 1.25 m. Në zonën kontrolluese doganore rruga është e ndërtuar sipas nevojave të njësisë doganore, respektivisht janë parashikuar ndërtimi i krosive të posaçme të reja për veturat, për autobusët dhe për mjetet e rënda trafikore.

Para këmbimores dhe postës është planifikuar ndërtimi i parkingjeve për vetura të lehta, kurse gjatë hyrjes dhe daljes terminali për mjetet e rënda transportuese është i ndarë me barriera.

6. PIKA KUFITARE SHËN NAUM

Pika kufitare Shën Naum ndodhet në një largësi prej 19 km larg Ohrit. Me këtë pikë kufitare lidhet qyteti i Ohrit nga Maqedonia dhe Pogradeci nga Shqipëria. Kjo pikë kufitare është e pozicionuar në drejtimin rrugor Ohër- Shën Naum - Pogradec dhe ndodhet në lartësi mbidetare prej 714 m.

Kjo pikë mundëson zhvillim dhe komunikim të shpejtë në zonën kufitare nga të dyja anët e Maqedonisë jugperëndimore me Pogradecin dhe Korçën në Shqipëri. Rruga gjer te kjo pikë kufitare shpie kryesisht përkaj bregut të liqenit nga njëra anë dhe pyjeve të ulëta interesante nga ana tjetër të cilat i japin veti të posaçme tërë kësaj zone turistike.

Momentalisht në pikën kufitare Shën Naum në Ohër për qarkullim në vendkalim nga ana R.M është vendosur Objekti qendrorë në të cilën ekzistojnë hapësira për doganë, policia për kontroll kufitar-administrativë postë, telefon, shpedicion dhe këmbimore. Për zgjidhje funksionale dhe konstruktive të kompleksit, ekziston projekt kryesor për zgjidhje urbanistike për vendosjen e objektit qendror –shtesë për doganën dhe policinë, si dhe plan për zgjerimin e rrugëve nga të dyja anët. Më pas parashikohet ndërtimi i tri krosive në të ardhëmen . Ato do të jenë dedikuara për kalimin e veturave të lehta, një krosi për autobusët, një për mjetet e rënda transportuese dhe një tjetër për veturat pa ndalesë. Gjithashtu, parashikohet

vendosja e një peshoreje, funksioni i së cilës momentalisht kryhet në Ohër. Sipas projektit parashikohet vendosja e një traseje për ndarje nga terminali doganor, ku parashikohen hapësira për njësitë inspektive, dogana dhe kontroll special, vendparkim për mjetet e rënda transportuese dhe veturat, objekt për tualet dhe restorant etj.

7. PIKA KUFITARE STENJE

Pika kufitare Stenje ndodhet larg Resnjës afro 11 km. Kjo pikë kufitare është atraktive nga fakti se ndodhet në pjesën jugore të lokalitetit turistik Oteshevë dhe pushimores Carina. **Stenja është vendbanim fshatar e cila viteve të fundit shënon rritje permanente të numrit të popullsisë.** P.sh. në regjistrimet e fundit (1994-2002), numri i popullsisë është rritur nga 321 banorë në 438 banorë, gjë e cila nuk ndodh me vendbanimet e tjera fshatare në fushëgropën e Prespës. Stenje ndodhet në lartësi mbidetare prej 855m, kurse vija kufitare shtrihet në lartësi mbidetare prej 942 m. Kjo pikë kufitare e lidh Maqedoninë me Shqipërinë në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë në drejtimin rrugor Resnjë-Stenjë, respektivisht Ohër-Oteshevë-Resnjë.

Pika kufitare Stenje ka karakter lokal ndërshtetërore, pasi që këtë pjesë të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, kufirin me vetura të lehta e kalojnë udhëtarët nga të dyja anët, kurse të rralla janë rastet kur në këtë pikë kufitare kalojnë autobusët apo mjetet e rënda transportuese. Përmes kësaj pike kufitare, kryesisht mbahen lidhjet familjare të maqedonaseve dhe të shqiptarëve (nga Prespa e Vogël) nga të dyja anët, kurse lëvizja e tyre realizohet në çdo kohë dhe në mënyrë të pandërprerë, përveç orëve të vona të natës. Kjo pikë kufitare karakterizohet me kushte malore klimatike, lartësi adekuate mbidetare, plazhe të mrekullueshme me rërë, pyje të pyjëzuara me vlerë të veçantë. Kushtet për ujësjellës janë të zgjidhura mirë.

Për këtë pikë kufitare ekziston projekt themelor me vendim të përpunuar urbanistik me objekt të vendosur në qendër për doganën dhe policinë, objekte të tjera ndjekëse për kryerjen e punës doganore etj. Parashikohet edhe modernizimi dhe zgjerimi i drejtimit rrugor Oteshevë-Stenjë, kurse në vet pikën kufitare janë parashikuar ndërtimi i tri krosive të dedikuara për kalimin e veturave të lehta, për autobusët dhe një krosi për mjetet e rënda transportuese. Përveç kësaj parashikohet vendosja e peshores në vet pikën kufitare, terminal doganor, hapësira për njësitë inspektuese, doganë dhe kontroll special, vendparkim për veturat dhe mjetet e rënda transportuese, objekte për shërbime shpeditore etj.

8. TË DHËNA NUMERIKE PËR VENDKALIMET KUFITARE TABANOCË DHE BOGORODICË (2003-2008)

Tabela 1. Lëvizja e udhëtareve në kalimin kufitar Tabanocë në Kumanovë dhe Bogoricë në periudhën prej vitit 2003-2008 .

Udhëtarët turistik								
Viti	Udhëtarët e RM		Udhëtarët e huaj		Gjithsej vendas (A)	Gjithsej të huaj (B)	Gjithsej vendas dhe huaj (A+B)	Dallimi Në mes A dhe B
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje				
Tabanoc-kalimi kufitar në kufirin Maqedono-Serbë								
2003	434387	430213	440381	320750	864600	761131	1625731	A
2004	411165	515959	589999	391676	927124	781675	1708799	A
2005	415645	527541	755258	568071	943186	1323329	2266515	B
2006	436848	507118	768911	530166	943966	1299077	2243043	B
2007	562348	590124	801245	564389	1112472	1365634	2478106	B
2008	526784	546797	789342	567812	1073581	1358154	2431735	B
Bogorodica-kalimi kufitar në kufirin Maqedono-Grekë								
2003	733408	756293	810311	942454	1489701	1752765	3242466	B
2004	466783	522594	580721	503413	989377	1084134	2073511	B
2005	460077	536765	758798	684501	996842	1443299	2440141	B
2006	516148	775566	704200	562852	1291714	1267052	2558766	A
2007	670182	784578	867394	807391	1454760	1674785	3129545	B
2008	532764	662237	712347	583467	1195001	1295814	2490815	B

Tabela 2 Qarkullimi i veturave në pikën kufitare Tabanocë gjatë periudhës 2003-08.

Qarkullimi i automjeteve të regjistruar në RM							
Viti	Automjetet			Autobusë			Gjithsej (A+B)
	Hyrje	Dalje	Gjithsej (A)	Hyrje	Dalje	Gjithsej (B)	
2003	42174	62864	105038	5629	6317	18178	123216
2004	35565	65575	101140	6165	5914	12079	113219
2005	40714	69684	110398	10796	7504	18300	128698
2006	41597	70576	112173	11358	6946	18304	130477
2007	66883	67511	134034	8176	6544	16321	134034
2008	62321	71325	113461	7546	7327	14873	128334
Automjetet dhe autobusët e jashtëm							
2003	145457	36308	181765	8854	9324	18178	199943
2004	183648	108232	291880	10276	9601	19877	311757
2005	185009	124544	309553	12207	12018	24225	333778
2006	199809	127273	327082	12267	18968	31235	358317
2007	143567	133465	277032	10231	11241	21472	298504
2008	156587	155277	311864	8432	7954	16386	328250

9. PËRFUNDIME

Ideja për modelimin dhe projektimin e shërbimeve turistike në ekonominë e vendit tonë është e patjetërsueshme për shkak të zhvillimit të tersishem për ekskursion, udhëtime për vikend, si nga vendi ynë drejt vendeve fqinje si dhe e kundërta. Zhvillimi i turizmit transitor në vendin tonë është i lidhur ngushtë me të ashtuquajturin turizëm urban, i cili ka të bëjë me shkallën e përdorimit të kapaciteteve për vendosje nëpër qytetet

gjatë së cilës kalojnë rrugët ndërkombëtare magjistrale, numri dhe cilësia e tyre përgjatë rrugëve magjistrale. Me interes është të potencohet se oferta turistike duhet të ngritet edhe në fushën e bujqësisë dhe në llojet e prodhimit të bujqësore. Në shumë kompani turistike apo ndërmarrje, ekzistojnë strategji të pavarura për zhvillimin e aktiviteteve turistike të cilat mes tjerash parashikojnë një varg aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e aktiviteteve primare, të cilat kanë pika të përbashkëta në lidhje me prodhimet bujqësore të cilat harxhohen në masë të madhe në zonat dhe në vendet turistike. Gjithashtu duhet të potencohet se për turizmi transitor përveç këtyre prodhimeve, me rëndësi janë edhe disa prodhime të tjera arti zanate, suvenire etj, të cilat i determinojnë shenjat nacionale të vendit tonë, mjedisin ambientel dhe kulturën, e cila ka tradita të thella në historinë e ekzistimit të civilizimit tonë në mesin e Gadishullit Ballkanik. Nënkuptohe se faktorët ekonomik të cilët hynë në determinantet e lëvizjeve aktuale në veprimtaritë e shërbimeve dhe në sistemin e konsumit, e të cilat procese sjellin arsytim ekonomik dhe dobi ekonomike, respektivisht këto procese sjellin përfitime ekonomike. Gjendja e sotme socialo-ekonomike e qytetarëve të Maqedonisë, papunësia dhe problemet e tjera që kanë të bëjnë me aktivitetin e popullatës së përgjithshme, tregojnë atë se pjesa më e madhe e popullatës nuk mund të inkuadrohen në aktivitete turistike.

REFERENCA:

1. Z.Zimeri, Turistickata valorizacija na granicnite premini na Republika Makedonija (magisterski trud), Skopje, 2006.
2. Andonovski.T&Malevski.I.(2001) Karakteristikat gjeomorfologjike të Luginës së Kumanovës, Pasqyra gjeografike.lib36.MGD.Shkup.39-40.
3. Budinski.M(1998):Burimet natyrore si një ndër përcaktuesit kryesorë në përcaktimin e regjionit optimal për zhvillimin e turizmit. Mbledhja e punimeve në takimin shkencor ndërkombëtar ‘‘Perspektivat dhe përmisimet e planifikimit dhe rregullimit të hapsirës’’ Ohër: Ministria e Zhvillimit Urban, Ndërtimi dhe Mbrojtjes së Mjedisit
4. Planifikimi hapsinor i Republikës së Maqedonisë,Shkup,1998.
5. Panov.N.(1996)Zhvillimi i turizmit në R.Maqedonisë.Përmbledhje e punimeve nga kongresi i parë i gjeografëve nga Republika e Maqedonis, mbajtur në Ohër nga 26-28.10.1995.
6. Selmani.A.(1995) Likova dje sot dhe nesër, Ekoritmi,Shkup.
7. Petkovski.P.Boyidar.K(1998) Koridoret e trafikut rrugor në R.Maqedonis dhe përdorimi i tyre. Përmbledhje nga punimet në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore.”Perspektivat dhe përmisimi i planifikimit dhe hapsirës”.Ohër. Ministria e Planifikimit Urban.dhe mbrojtja e mjedisit,1998